



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 109, Datë 19.05.2022

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË
“DANSKE COMMODITIES ALBANIA” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, gërma “d”, të Ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “e”; pika 5, pika 1, gërma “e”; nenit 10, pikat 1 dhe 3, dhe nenit 16, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016; nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, gërma “a”, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.05.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 668/4 prot., datë 19.05.2022, “Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë “DANSKE COMMODITIES ALBANIA” sh.p.k., me nr. 374, seria T12/T17, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 94, datë 04.07.2017”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “DANSKE COMMODITIES ALBANIA” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 477/1 prot., datë 04.05.2022, ka paraqitur aplikimin për rinovimin e licencës nr. 374, seria T12/T17, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Në nenin 16, pika 1, përcaktohet se, paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës bëhet jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë. Në zbatim të këtij neni shoqëria duhet ta paraqesë aplikimin brenda datës 04.05.2022. Sikurse konstatohet shoqëria e ka paraqitur aplikimin e saj më datë 04.05.2022, pra brenda afatit të parashikuar sipas këtij neni.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për rinovimin e licencës së tregtimit të energjisë elektrike nga ERE, në zbatim të Aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për

dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.

- Në zbatim të përcaktimeve të “*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*”, e ndryshuar, aplikuesi duhet të depozitojë në ERE: Formatin dhe dokumentacionin për aplikim; Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor; Dokumentacionin financiar dhe fiskal; si dhe Dokumentacionin teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike. Sa rezulton nga ky aplikim shoqëria ka përcjellë dokumentacionin si vijon:
 - Formati dhe dokumentacioni për aplikim - Neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” dhe “c”. **Plotësuar.**
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor - Neni 9, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “e”. **Plotësuar.**
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal - Neni 9, pika 3, gërmat “b” dhe “d”. **Plotësuar.**
 - Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike - Neni 9, pika 4.8, gërmat “a”, “b” dhe “d”. **Plotësuar.**
- Në lidhje me dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me:

Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, Neni 9, pika 2:

- **gërma “d”** (vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë).
Shoqëria duhet të depozitojë vërtetimet e gjykatës dhe prokurorisë për administratorin e saj, në rast se ai rezulton rezident në Shqipëri.

Dokumentacioni financiar dhe fiskal. Neni 9, pika 3:

- **gërma “a”** (vërtetimi për shlyerjen e tatim – taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore).
Shoqëria duhet të informojë se si ka vijuar procesi i apelit administrativ dhe i shlyerjes së detyrimeve ndaj insitucionit tatimor.
- **gërma “c”** (dokumenta që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera).
Shoqëria duhet të përcjellë në ERE dokumentacion mbështetës financiar në të cilin shprehen qartë vlerat monetare që do ti shërbejnë kësaj veprimtarie.

Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, Neni 9, pika 4.8

- **gërma “b”** (Kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare) i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie, i shoqëruar me vërtetim nga banka apo institucione të tjera financiare të njohura me ligj).

Shoqëria duhet të përcjellë në ERE kapitalin financiar për ushtrimin e veprimtarisë, të shoqëruar me dokumentacion mbështetës.

- Shoqëria ka shlyer të gjitha detyrimet për pagesat rregullatore ndaj ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “DANSKE COMMODITIES ALBANIA” sh.p.k., me nr. 374, seria T12/T17, në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ere-s nr. 94, datë 04.07.2017.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s,- brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI